

Vështrim mbi tregjet

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar- Shkurt 2022

Zhvillime të tjera

- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, takim me misionin e Bankës Botërore
- Investimet e Diasporës përmes instrumenteve të reja financiare, Drejtori i AMF-së në aktivitetin e “Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare”
- Përlllogaritësi i dëmeve në faqen e AMF-së gjen përdorim të zgjeruar

Publikime Profesionale

- BIS Hapja financiare dhe pabarazia
- Global Risk Regulator - Sanksionet perëndimore kërcënojnë krizë bankare ruse
- Bankat bëjnë thirrje për një qasje të kujdesshme ndaj monedhave dixhitale
- IOSCO Financat e decentralizuara

Informacione Ndërkombëtare

- Bosnje – Hercegovina
- Greqi
- Hungari
- Kosovë
- Moldavi
- Poloni

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

VËSHTRIM MBI TREGJET

Ecuria e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar–Shkurt 2022

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-shkurt 2022 kapën vlerën 2,800 milionë lekë, ose 0.82% më pak se në janar-shkurt 2021. Gjatë periudhës janar-shkurt 2022, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 167,157 me një rritje prej 19.39% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.67% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 7.31%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 37.64% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 62.36% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-shkurt 2022, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 840 milionë lekë, ose 39.87% më pak se në periudhën janar-shkurt 2021, kjo ulje është e ndikuar nga vazhdimësia e pagesave për dëmshpërblime nga tërmetet e fundvitit 2019 gjatë janar-shkurtit 2021.

Ndërkohë dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-shkurt 2022 kapën vlerën 623 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 0.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-shkurt 2022 kapën vlerën 623 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 0.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar - Shkurt 2022 (Në %)



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, takim me misionin e Bankës Botërore



23 mars 2022 – Takim me misionin e Bankës Botërore

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete, zhvilloi një takim me ekipin e misionit të Bankës Botërore për sektorin financiar. Çështjet kryesore të diskutuara gjatë këtij takimi kishin të bënin me ecurinë e tregjeve financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit, masat për menaxhimin e rrezikut të katastrofave, projektligjin e ri për fondet private të pensioneve, si edhe zbatimin e projektit të asistencës me mbështetjen e Bankës Botërore, të financuar nga SECO.

Në fjalën e tij, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së vuri në dukje se viti 2021 shënoi rimëkëmbjen e tregjeve financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit, si edhe rikthimin e tyre në trendin rritës. Megjithatë, Autoriteti do të vijojë të tregojë kujdes të shtuar në monitorimin e treguesve kryesorë të shëndetit financiar të shoqërive që operojnë në tregjet nën mbikëqyrje.

Z. Mete theksoi se përgjatë dy viteve të fundit Autoriteti, i mbështetur edhe nga ekspertiza e Bankës Botërore, ka realizuar riformatimin e pjesës kryesore të ligjeve të tregjeve nën mbikëqyrje, si edhe është në fazën finale të plotësimit të akteve nënligjore në zbatim të këtyre ligjeve. Gjithashtu, është hartuar projektligji i ri për fondet private të pensioneve, i cili realizon një përafrim me Direktivën IORP II të Bashkimit Evropian, si edhe synon të zgjerojë më tej mundësitë e zhvillimit të tregut të fondeve private të pensioneve.

Përfaqësuesit e misionit të Bankës Botërore vlerësuan se përgjithësisht efektet e pandemisë në tregjet financiare ishin të kufizuara dhe situata për momentin parashikohet e qëndrueshme. Megjithatë, situata do të monitorohet në vijimësi, nëse do të ketë efekte të mundshme në të ardhmen. Gjithashtu, ata shprehën gadishmërinë për të vijuar bashkëpunimin me Autoritetin në funksion të projekteve të asistencës.

Përfaqësuesit e misionit të Bankës Botërore vlerësuan se përgjithësisht efektet e pandemisë në tregjet financiare ishin të kufizuara dhe situata për momentin parashikohet e qëndrueshme.

Investimet e Diasporës përmes instrumenteve të reja financiare, Drejtori i AMF në aktivitetin e “Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare”



24 mars 2022 – Aktiviteti i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, z. Ervin Mete ishte i pranishëm në aktivitetin e organizuar nga Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare “Perspektiva e re e investimit në Atdhe”. Në fjalën e mbajtur, z. Mete u përqendrua te mundësitë dhe hapësirat e krijuara përmes ligjeve të reja për tregjet e kapitalit dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive për përfshirjen e Diasporës në investime në Shqipëri nëpërmjet instrumenteve të reja financiare.

Ligji “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” ka mundësuar krijimin e fondeve alternative të investimit, si edhe ka krijuar hapësira për kanalizimin edhe të investimeve të diasporës nëpërmjet fondeve me kapital privat në projekte zhvillimi në Shqipëri. Gjithashtu, me ligjin e ri për tregjet e kapitalit është krijuar arkitektura e nevojshme ligjore dhe është plotësuar infrastruktura për tregtimin e instrumenteve të reja financiare, siç mund të jetë Obligacionet e Diasporës.

Kuadri ligjor e rregullator mundëson emetimin e obligacioneve me ofertë publike, përveç emetimeve të deritanishme me ofertë private. Në këtë mënyrë, Korporatat Publike mund të emetojnë obligacione me ofertë publike, të drejtuara ndaj diasporës, për të gjeneruar financime për projekte të veçanta zhvillimi, të cilat mund të përfshijnë direkt Diasporën Shqiptare përmes blerjes së këtyre titujve.

Z. Ervin Mete u përqendrua te mundësitë dhe hapësirat e krijuara përmes ligjeve të reja për tregjet e kapitalit dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive për përfshirjen e diasporës në investime në Shqipëri nëpërmjet instrumenteve të reja financiare.

Përlllogaritësi i dëmeve në faqen e AMF-së gjen përdorim të zgjeruar

Kujdes! Plotësoni fushat e detyruara të shënuara me *.

Të dhënat tuaja

Data e aksidentit*	Datëlindja*
dd/mm/yyyy	dd/mm/yyyy
Gjinia*	Të ardhurat Personale Vjetore në kohën e ngjarjes*
Zgjidhni gjininë	
Koeficienti i Humbjes së Aftësisë për Punë*	Numri i Personave në ngarkim*
Zgjidhni një opcion	
Punësimi*	Motra / Vëllezer*
Zgjidhni një opcion	
Shpenzimet Farmaceutike & Spitalore*	


Përlllogaritësi i dëmeve ndaj personit, në rastet e aksidenteve nga mjetet motorike në sektorin e transportit, i prezantuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe i publikuar në faqen e tij zyrtare në fund të vitit të kaluar, ka gjetur përdorim të zgjeruar nga mbi 23 mijë qytetarë/profesionistë të fushës/persona të interesuar në dy muajt e parë të vitit 2022.

Aplikacioni bazohet në Rregulloren nr. 125, datë 28.07.2021 "Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", miratuar nga Autoriteti në zbatim të ligjit të ri për "Sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i cili hyri në fuqi më 1 korrik 2021.

Aplikacioni u zhvillua nga Autoriteti për t'i ardhur në ndihmë palëve përfituese, si edhe vetë ekspertëve të fushës në vlerësimin e dëmeve dhe trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim. Përlllogaritësi bazohet në disa supozime, vlerat e përlllogaritura janë orientuese dhe synojnë të informojnë përdoruesit mbi masën e dëmshpërblimit në rastet e dëmit ndaj personit, me pasojë paaftësinë e përhershme për punë ose me pasojë vdekjen.

Nëpërmjet aplikacionit në linkun <https://crm.amf.gov.al/deme> realizohet përlllogaritja automatike e vlerës së dëmit, përmes plotësimit manual të fushave të kërkuara, duke pasqyruar vlerën për çdo figurë dëmi dhe duke bërë transparencë mbi vlerën e dëmit pasuror dhe dëmit jopasuror. Aplikacioni shërben gjithashtu në funksion të edukimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve në fushën e sigurimeve.

Aplikacionit ndodhet
në linkun
<https://crm.amf.gov.al/deme>



BIS Working Papers

No 1010

Financial openness and
inequality

by Stefan Avdjiev and Tsvetana Spasova

Monetary and Economic Department

March 2022

Hapja financiare dhe pabarazia

BIS – Material Studimor | Nr 1010 | 24 mars 2022
nga Stefan Avdjiev dhe Cvetana Spasova

Abstrakt

Studimi kryen një hetim empirik gjithëpërfshirës të lidhjes midis pabarazisë dhe hapjes financiare. Studimi dokumenton se marrëdhënia ndryshon në mënyrë të konsiderueshme jo vetëm me kalimin e kohës, por edhe ndërmjet komponentëve kryesorë të totalit të detyrimeve të jashtme, të cilat janë anashkaluar kryesisht nga literatura ekzistuese. Në ekonomitë e tregut në zhvillim (EME's), një rritje në detyrimet e jashtme të një vendi shoqërohet me një rritje fillestare dhe një rënie të mëvonshme të pabarazisë. Kjo duket se nxitet nga fakti se kanalet përmes të cilave hapja financiare rrit pabarazinë prirën të jenë aktive menjëherë, ndërsa kanalet për uljen e pabarazisë prirën të funksionojnë me vonesë. Lidhja midis hapjes financiare dhe pabarazisë prirët të jetë më e vogël në ekonomitë e përparuara sesa në EME.



<https://www.bis.org/publ/work1010.htm>



Subjects / Regulatory Relations

Western sanctions threaten Russian banking crisis

Justin Pugsley | March 4, 2022



Following Russia's invasion of Ukraine, the West and its allies have unleashed a tsunami of financial sanctions against Russia – the harshest ever on a G20 nation – leaving banks on both sides stuck in the crossfire.

1. Sanksionet perëndimore kërcënojnë krizë bankare ruse (Western sanctions threaten Russian banking crisis)

Justin Pugsley

Pas sulmeve të Ruisë mbi Ukrainën, Perëndimi dhe aleatët e tij kanë lëshuar një cunami sanksionesh financiare kundër Ruisë – më të ashprat ndonjëherë në një vend të G20 – duke i lënë bankat nga të dyja palët të mbërthyera në konflikt.

2. Bankat bëjnë thirrje për një qasje të kujdesshme ndaj monedhave dixhitale (Banks call for cautious approach to digital currencies)

Justin Pugsley

Bankat u bëjnë thirrje bankave qendrore që të punojnë ngushtë me to në zhvillimin e monedhave dixhitale për tregjet financiare me shumicë, për të shmangur kërcënimin e stabilitetit financiar.

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Regulatory-Relations/Western-sanctions-threaten-Russian-banking-crisis?ct=true>

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Financial-Markets/Banks-call-for-cautious-approach-to-digital-currencies?ct=true>



IOSCO shpjegon se si Financat e Decentralizuara ("DeFi") po klonojnë tregjet financiare

IOSCO ka publikuar më 24 mars 2022 një raport të detajuar që përcakton se si financat e decentralizuara ("DeFi") po evoluojnë shpejt për të reflektuar atë çfarë ndodh në tregjet financiare konvencionale.

Ashley Alder, Kryetar i IOSCO-s dhe Drejtuesi Ekzekutiv i Komisionit të Titujve dhe të Futures (Securities and Futures Commission, SFC) të Hong Kongut, tha: "DeFi është një zonë e re dhe me rritje të shpejtë të shërbimeve financiare dhe ky raport përshkruan fushat kryesore të shqetësimit për IOSCO".

<https://www.iosco.org/library/publicdocs/pdf/IOSCOPD699.pdf>

Raporti i IOSCO ofron një përmbledhje gjithëpërfshirëse të tregut DeFi në zhvillim të shpejtë, produkteve, shërbimeve të tij të reja dhe pjesëmarrësve kryesorë. Ai identifikon disa produkte dhe shërbime që janë të reja për DeFi. Por shumica e shërbimeve të reja që po shfaqen, përsërisin më shumë shërbime dhe aktivitete financiare tradicionale, por me rregullim më të dobët dhe rrezik të shtuar për investitorët.

Raporti hedh dyshime mbi një pretendimin kryesor të novatorëve të DeFi se ai është një treg i drejtpërdrejtë midis dy apo më shumë pjesëmarrësve, "peer-to-peer" pa kontroll të brendshëm të centralizuar. Duke parë në detaje se si funksionon DeFi, ai identifikon aktorët qendrorë të cilët, si përfundim, shpesh mbajnë kontrollin - për shembull, përmes shpërndarjes së "tokens të qeverisjes". Ai gjithashtu thekson rolin e rëndësishëm që luajnë platformat e centralizuara tregtare, të cilat shpesh përballen me konflikte të konsiderueshme interesi.

Në përgjigje të këtij raporti, IOSCO ka krijuar një task force të re. Tuang Lee Lim, Ndihmës Drejtor Menaxhues (Tregjet e Kapitalit) i Autoritetit Monetar të Singaporit (MAS) dhe kryetar i kësaj task force të re tha: "Raporti ofron dëshmi si për mundësitë ashtu edhe për rreziqet e ndjeshme që DeFi mund t'u sjellë investitorëve dhe tregjeve. Vendimi i IOSCO-s për të krijuar grupin e punës nënkupton vendosmërinë e anëtarëve tanë për të ndërmarrë veprime politike në kohë dhe të koordinuara për të trajtuar në mënyrë të përshtatshme rreziqet që rrjedhin nga kjo zonë me rritje të shpejtë ...".

IOSCO ka bërë thirrje për komente dhe vlerësime nga publiku, përfshirë tregun e krypto-aseteve dhe pjesëmarrësit e DeFi dhe nga çdo palë tjetër e interesuar, mbi çështjet e ngritura në raportin e saj DeFi, si dhe për çdo krypto-aset ose çështje të lidhura me DeFi.

INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

BOSNJE-HERCEGOVINA

www.xprimm.com

Sipas shifrave të publikuara nga agjencia e sigurimeve të Bosnje-Hercegovinës, AZOBiH, në fund të vitit 2021, tregu i sigurimeve në BiH arriti në 418.44 milionë euro ose rreth 8.19% më shumë në krahasim me vitin e kaluar.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 7.3% krahasuar me vitin e kaluar duke arritur në 329 milionë euro, në fund të vitit 2021. Ndërkohë primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 11.8% duke arritur në 89.37 milionë euro. Në sigurimet e Jo-Jetës, sigurimet e pronës arritën vëllimin e 32.22 milionë euro, ndërsa sigurimet motorike (TPL dhe Kasko) realizuan prime në vlerën e 249.76 milionë euro.

Vlera e primeve të shkruara bruto që veprojnë në Federatën e Bosnje-Hercegovinës u rrit me 8.26% duke arritur në 292.86 milionë euro, ndërsa siguruesit në Republikën Serbe të Bosnje-Hercegovinës gjeneruan 125.58 milionë euro, me rritje 8.0% më shumë se një vit më parë.

GREQI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të tregut të publikuara nga Shoqata Helenike e Shoqërive të Sigurimeve, HAIC, tregu grek i sigurimeve në fund të 2021 arriti në 4.26 miliardë euro, duke shënuar një rritje me 7.7% krahasuar me vitin 2020.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimet e Jo-Jetës u rrit me 5.7% krahasuar me vitin 2020, duke arritur në vlerën e 2.26 miliardë euro, ndërsa sigurimet e Jetës u rritën me 10% duke realizuar rreth 2 miliardë euro prime.

Sigurimet e Jetës të lidhura me skemat e kursimeve shënuan një rritje prej 57.7% duke arritur në 630 milionë euro, ndërsa policat tradicionale të sigurimit të Jetës patën një normë negative duke zbritur me -4.5% krahasuar me vitin 2020. Në sigurimet e Jo-Jetës, vetëm sigurimi motorik pësoi rënie me -1% krahasuar me vitin 2020 duke arritur në 727 milionë euro, ndërsa të gjitha produktet kryesore shënuan norma pozitive.

HUNGARI

www.xprimm.com

Sipas statistikave më të fundit të publikuara nga Banka Kombëtare e Hungarisë, në fund të vitit 2021, primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 13.64% krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 602.7 miliardë HUF ose rreth 1.6 miliardë euro. Ndërsa sigurimet e Jo-Jetës u rritën me 7.9% duke arritur në 726.8 miliardë HUF ose 1.9 miliardë euro. Gjatë vitit 2021 sigurimet e Jetës zinin 45% dhe sigurimet e Jo-Jetës zinin 55% të vëllimit të përgjithshëm të primeve të shkruara bruto.

Edhe pagesat e dëmeve u rritën me 7.1% krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 703 miliardë HUF ose 1.9 miliardë euro. Rritjen më të madhe e kishin dëmet e shkaktuara në sigurimin e Jetës me rritje 8.1% në vit duke arritur në 426 miliardë HUF, ndërsa dëmet në sigurimet e Jo-Jetës arritën në 277 miliardë HUF me rritje 5.8% në vit.

Përsa i takon numrit të kontratave të sigurimit, në fund të vitit 2021, numri i tyre u rrit me 1.2% krahasuar me vitin 2020, duke reflektuar rritje me 175,300 kontrata të reja. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga rritje prej 1.73% e numrit të kontratave të sigurimit të Jo-Jetës, e shoqëruar me një rënie të numrit të kontratave të sigurimit të Jetës me rënie prej 1,43% në vit. Si rezultat, numri i përgjithshëm i kontratave të sigurimit arriti në 14.65 milionë në fund të vitit 2021.

Në fund të vitit 2021, portofoli total i kontratave të shoqërive të sigurimit u rrit me 1.5% nga niveli i një viti më parë, duke reflektuar një rritje prej mbi 217,500 të numrit të kontratave të reja. Kjo ka ardhur kryesisht nga një rritje prej 2% e numrit të kontratave të sigurimit të Jo-Jetës (në 12.33 milionë), shoqëruar nga një rënie e numrit të kontratave të sigurimit të Jetës (një rënie prej 1.03% në 2.31 milionë). Si rezultat, numri i përgjithshëm i kontratave të sigurimit arriti në 14.65 milionë në fund të tremujorit të katërt 2021.

Në fund të tremujorit të katërt 2021, numri i shoqërive të sigurimit që i nënshtrohen Solvency II mbeti i pandryshuar në raport me periudhën e mëparshme. Numri i institucioneve të mbikëqyrura në tregun e sigurimeve është 22 nga këta 4 sigurues të specializuar në sigurimin e Jetës, 9 sigurues të Jo-Jetës dhe 9 sigurues kompozitë (Jetë dhe Jo-Jetë).

KOSOVA

www.xprimm.com

Sipas shifrave të publikuara në faqen zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës, tregu i sigurimeve në Kosovë pati një rritje dyshifrore gjatë vitit 2021. Vlera e primeve të shkruara bruto arriti në 119.23 milionë euro, duke u rritur me 17.44% në krahasim me vitin 2020. Në të njëjtën kohë, totali i dëmeve të paguara bruto u rrit me 18.45% duke arritur në 61 milionë euro dhe kjo për shkak të rritjes së madhe të dëmeve në Policat Kufitare (+107.26%). Primet e shkruara bruto nga sigurimet e Jo-Jetës arritën në 114.33 milionë euro, ndërsa primet në sigurimin e Jetës u rritën në 4.9 milionë euro.

Gjatë vitin 2021, siguruesit lëshuan gjithsej 1.15 milionë polica sigurimi të Jo-Jetës krahasuar me 824 mijë polica sigurimi të lëshuara në vitin 2020. Numri më i madh i policave të sigurimit i takonte produktit MTPL e brendshme me 485 mijë polica përkundrejt 413 mijë që ishin në vitin 2020) si edhe policat kufitare me 447 mijë kundrejt 217 mijë në vitin 2020.

Në tregun e Kosovës veprojnë 13 kompani sigurimi, 11 sigurues të Jo-Jetës dhe dy kompani sigurimi të Jetës.

MOLDAVI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Komisioni Kombëtar i Tregut Financiar në Moldavi, tregu i sigurimeve në vend e mbylli vitin 2021 me një rritje prej 31.58%, e shprehur në monedhën vendase duke arritur në 1.92 miliardë MDL, ose rreth 95.87 milionë euro. Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara u rritën me vetëm 11% duke arritur në 662 milionë MDL.

Rritja e tregut mbështetet ende nga sigurimet e Jo-Jetës, të cilat u rritën me 35% dhe pesha e tyre në totalin e tregut arriti në pothuajse 95%. Ndërsa primet e shkruar bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 0.36%.

Sigurimet motorike mbeten segmenti kryesor, duke zënë mbi 66% të tregut. Rritja e MTPL-së në vitin e kaluar ishte pothuajse 27%, ndërsa ritmi i rritjes së Kartonit të Jeshil ishte mbi 50%. Sigurimet shëndetësore u rritën me rreth 80% dhe sigurimet e pasurisë patën rritje me 73%.

Në total, dëmet e paguara shënuan rënie vjetore me rreth 32% në sigurimet e pasurisë, ndërsa në sigurimet e Jetës, sigurimet shëndetësore, sigurimet motorike ka pasur rritje të ndjeshme.

POLONI

www.xprimm.com

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në tregun polak të sigurimeve, gjatë vitit 2021, pati një rritje vjetore prej 9.5% duke arritur në 15.05 miliardë euro. Rritje patën edhe dëmet e paguara, ndonëse me rritën rritje më të ulët se primet, duke arritur në 8.98 miliardë euro dhe rritje me 4.5% më shumë se në vitin 2020. Sigurimet e Jo-Jetës, veçanërisht linjat e sigurimit të pronës dhe sigurimet motorike ishin ato që sollën pjesën më të madhe të rritjes së tregut.

Sigurimet motorike ruajtën pozicionin e tyre dominues në portofolin e sigurimeve të Jo-Jetës, ndonëse pesha e sigurimet MTPL në portofolin e tregut u zvogëlua, ndofta si pasojë e tendencës së vazhdueshme të rënies së tarifave MTPL. Kështu, ndërsa në vitin 2019 vlera mesatare e primit MTPL qëndroi në 500 PLN ose 117.4 euro, ndërsa në vitin 2020 kjo vlerë u rrit pak në monedhën vendase, duke arritur në 523 PLN, por në tremujorin e tretë të 2021 ra në 486.8 PLN ose rreth 105 euro. Në një tendencë të kundërt, vlera mesatare e dëmeve të sigurimit MTPL-së u rrit vazhdimisht gjatë të njëjtës periudhë, duke arritur në 8,367.7 PLN ose rreth 1,806.14 euro në tremujorin e tretë të vitit 2021.

Sigurimi i pronës pati ritme dyshifrore rritjeje të primit me 17.35%, duke arritur vlerën e primeve të shkruara bruto 1.93 miliardë euro. Rritja më e fortë u raportua për linjën “Dëme në pronë”, përfshirë sigurimet bujqësore, ku primet u rritën me 22.48%, duke arritur në 972.35 milionë euro.

Sektori i sigurimeve të Jetës përjetoi një dinamikë të përgjithshme pozitive. Vëllimi i primeve të shkruara bruto në këtë kategori arriti në 4.81 miliardë euro, me rritje 7% më shumë krahasuar me vitin 2020.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al